<p>4. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit duhet të përmbajë arsyet e shtyrjes, provat që mbështesin shtyrjen dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet shtyrja.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit</p> <p>1. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit i parashtrohet kryetarit të gjykatës kompetente themelore.</p> <p>2. Nëse provat nuk i bashkëngjiten kërkesës, kryetari i gjykatës themelore e urdhëron personin e dënuar që provat t'i parashtrojë brenda tetë (8) ditëve me paralajmërim se në të kundërtën kërkesa e tij do të hudhet.</p>	<p>4. The request for postponement of execution must contain the reasons for the postponement, the evidence supporting the postponement and the period of time for which the postponement is requested.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Request for postponement of the execution of the sentence</p> <p>1. The request for postponement of the execution is submitted to the president of the competent basic court.</p> <p>2. If the evidence is not attached to the request, the president of the basic court shall order the convicted person to submit the evidence within eight (8) days with a warning that otherwise his request will be rejected.</p>	<p>4. Zahtev za odlaganje izvršenja mora da sadrži razloge za odlaganje, dokaze koji potkrepljuju zahtev za odlaganje i period na koji se traži odlaganje.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Molba za odlaganje izvršenja kazne</p> <p>1. Molba za odlaganje izvršenja podnosi se predsedniku nadležnog osnovnog suda.</p> <p>2. Ako uz zahtev nisu priloženi dokazi, predsednik osnovnog suda nalaže osuđenom licu da podnese dokaze u roku od osam (8) dana i upozorava ga da će u suprotnom njegov zahtev biti odbijen.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Vendosja lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit</p> <p>1. Kryetari i gjykatës kompetente themelore vendosë lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kërkesës. Para marrjes së vendimit gjykata mund të zbatojë hetime të nevojshme për vërtetimin e fakteve të parashtruara në kërkesë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Decision on the request for postponement of the execution of the sentence</p> <p>1. The President of the competent basic court shall decide on the request for postponement of the execution of the sentence within three (3) days from the receipt of the request. Prior to the decision, the court may conduct the necessary investigations to establish the facts set forth in the request.</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Odluka u vezi sa molbom za odlaganje izvršenja kazne</p> <p>1. Predsednik nadležnog osnovnog suda odlučuje o zahtevu za odlaganje izvršenja kazne u roku od tri (3) dana od prijema zahteva. Pre nego što donese rešenje sud, može da sprovede potrebnu istragu kako bi utvrdio činjenice iz zahteva.</p>

<p>2. Kryetari i gjykatës kompetente themelore e hedh kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit nëse kërkesa:</p> <p>2.1. nuk është paraqitur me kohë;</p> <p>2.2. është paraqitur nga personi i paautorizuar;</p> <p>2.3. nuk iu janë bashkangjitur me kohë provat që e mbështesin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Ankesa</p> <p>1. Kundër aktvendimit të shkallës së parë, personi i dënuar mund t'i parashtrojë ankesë kryetarit të Gjykatës së Apelit brenda tri (3) ditëve nga pranimi i aktvendimit.</p> <p>2. Kryetari i Gjykatës së Apelit vendosë për ankesën brenda tri (3) ditëve nga pranimi i saj.</p>	<p>2. The president of the competent basic court shall dismiss the request for postponement of the execution of the sentence if the request:</p> <p>2.1. is not submitted in time;</p> <p>2.2. is submitted by an unauthorized person;</p> <p>2.3. the supporting evidence was not attached in time.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 Complaint</p> <p>1. Against the first instance ruling, the convicted person may file an appeal to the President of the Court of Appeals within three (3) days from the receipt of the ruling.</p> <p>2. The President of the Court of Appeals shall decide on the appeal within three (3) days from its receipt.</p>	<p>2. Predsednik nadležnog osnovnog suda odbacuje zahtev za odlaganje izvršenja kazne:</p> <p>2.1 ako zahtev nije podnet blagovremeno;</p> <p>2.2 ako je zahtev podnelo neovlašćeno lice;</p> <p>2.3 ako uz zahtev nisu blagovremeno priloženi popratni dokazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Žalba</p> <p>1. Osuđeno lice može da uloži žalbu na prvostepeno rešenje predsedniku Apelacionog suda u roku od tri (3) dana od prijema rešenja.</p> <p>2. Predsednik Apelacionog suda odlučuje o žalbi u roku od tri (3) dana od prijema žalbe.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 25 Peçullimi i ekzekutimit të dënimit për shkak të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit</p> <p>1. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit e pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim, derisa të merret vendim i formës së prerë lidhur me kërkesën.</p> <p>2. Kryetari i gjykatës kompetente themelore, i cili pas refuzimit të dytë të kërkesës konstaton se e drejta në ankesë është keqpërdorur, vendosë që ankesa të mos e shtyj ekzekutimin e vendimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Suspension of execution of the sentence due to request for postponing the execution</p> <p>1. The request for postponement of the execution shall suspend the execution of the imprisonment sentence, until a final decision is made regarding the request.</p> <p>2. The President of the competent basic court, who after the second rejection of the request finds that the right to appeal has been misused, shall decide that the appeal shall not postpone the execution of the decision.</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Obustavljanje izvršenja kazne zbog molbe za odlaganje</p> <p>1. Zahtev za odlaganje izvršenja zadržava izvršenje kazne do pravosnažnosti odluke kojom je odlučeno po zahtevu.</p> <p>2. Predsednik nadležnog osnovnog suda koji posle odbijanja zahteva po drugi put utvrdi da je pravo na zahtevanje odlaganja zloupotrebljeno, donosi odluku da žalba ne odlaže izvršenje odluke.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Raporti për gjendjen shëndetësore për shkak të sëmundjes së rëndë</p> <p>Personi i dënuar, të cilit i është shtyrë ekzekutimi i dënimit për shkak të sëmundjes së rëndë akute, duhet të dorëzojë raport mbi gjendjen e tij shëndetësore të lëshuar nga institucioni mjekësor ku është duke u trajtuar një herë në tre (3) muaj, ose me kërkesë të gjykatës kompetente, edhe më shpesh.</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Report on health status due to serious illness</p> <p>The convicted person, whose execution of the sentence has been postponed due to a serious acute illness, must submit a report on his health condition issued by the medical institution where he is being treated once every three (3) months, or with request of the competent court, even more often.</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Izveštaj o zdravstvenom stanju zbog teške bolesti</p> <p>Osuđeno lice kojem je odloženo izvršenje kazne zbog ozbiljne akutne bolesti mora da dostavlja izveštaj o svom zdravstvenom stanju od medicinske institucije u kojoj se nalazi na lečenju jednom u tri (3) meseca, a na zahtev nadležnog suda i češće.</p>

<p align="center">Neni 27 Revokimi dhe ndërprerja e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim</p>	<p align="center">Article 27 Revocation and termination of the postponement of the execution of the imprisonment sentence</p>	<p align="center">Član 27 Opoziv i prekid odlaganja izvršenja kazne zatvora</p>
<p>1. Kryetari i gjykatës kompetente themelore e revokon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim, nëse ndërkohë konstatohet se arsyet për lejimin e shtyrjes nuk kanë ekzistuar, ose kanë pushuar së ekzistuari, ose personi i dënuar e ka shfrytëzuar periudhën e shtyrjes për qëllime të tjera e jo për ato për të cilat është lejuar.</p> <p>2. Nëse shtyrja i është lejuar gruas shtatzënë, fëmija i së cilës nuk ka lindur i gjallë, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas lindjes, dhe nëse fëmija vdes pas lindjes, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas vdekjes së fëmijës.</p> <p>3. Nëse shtyrja i është lejuar nënës së fëmijës më të ri se një (1) vit i cili vdes, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas vdekjes së fëmijës.</p>	<p>1. The president of the competent basic court shall revoke the postponement of the execution of the imprisonment sentence, if in the meantime it is ascertained that the reasons for allowing the postponement did not exist, or have ceased to exist, or the convicted person has used the postponement period for purposes other than for those for which it is permitted.</p> <p>2. If the postponement is allowed to a pregnant woman whose child has not been born alive, the postponement is terminated six (6) months after birth, and if the child dies after birth, the postponement is terminated six (6) months after the death of the child.</p> <p>3. If the postponement is allowed to the mother of a child younger than one (1) year who dies, the postponement is terminated six (6) months after the death of the child.</p>	<p>1. Predsednik nadležnog osnovnog suda opozvaće odlaganje izvršenja kazne zatvora ako se naknadno ustanovi da razlozi za odobrenje odlaganja nisu postojali ili su prestali da postoje, ili da je osuđeno lice iskoristilo period odlaganja u neku drugu svrhu a ne onu zbog koje mu je odobreno odlaganje.</p> <p>2. Ako je odlaganje odobreno trudnici koja potom rodi mrtvo dete, odlaganje se prekida šest (6) meseci posle porođaja, a ako dete umre posle porođaja, odlaganje se prekida šest (6) meseci od smrti deteta.</p> <p>3. Ako je odlaganje odobreno majci deteta mlađeg od godinu dana koje potom umre, odlaganje se prekida šest (6) meseci od smrti deteta.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 28</p> <p style="text-align: center;">Ankesa kundër aktvendimit për revokimin, ose ndërprerjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim</p> <p>1. Personi i dënuar me burgim ka të drejtë ankese kundër aktvendimit për revokimin, ose ndërprerjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim nën kushte të njëjta, si edhe kundër aktvendimit në bazë të cilit është vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje.</p> <p>2. Ankesa e shtynë ekzekutimin e aktvendimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 28</p> <p style="text-align: center;">Appeal against the decision for revocation or termination of the postponement of the execution of the imprisonment sentence</p> <p>1. A person sentenced to imprisonment has the right to appeal against the decision for revocation or termination of the postponement of the execution of the imprisonment sentence under the same conditions, as well as against the ruling rendered on the request for postponement.</p> <p>2. The appeal shall postpone the execution of the ruling.</p>	<p style="text-align: center;">Član 28</p> <p style="text-align: center;">Žalba na rešenje o opozivanju ili prekid odlaganja izvršenja kazne zatvora</p> <p>1. Lice osuđeno na kaznu zatvora ima pravo žalbe na rešenje o opozivu ili prekid odlaganja izvršenja kazne zatvora pod istim uslovima kao i za žalbu na rešenje kojim je odlučeno o zahtevu za odlaganje.</p> <p>2. Žalba odlaže izvršenje rešenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 29</p> <p style="text-align: center;">Shtyrja e ekzekutimit lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike</p> <p>1. Gjykata që vendos lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës penale të parashtruar në favor të personit të dënuar, mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit me burgim, edhe para hyrjes në fuqi të aktvendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 29</p> <p style="text-align: center;">Postponement of execution related to extraordinary legal remedies</p> <p>1. The court that decides on the request for repetition of the criminal procedure filed in favor of the convicted person, may postpone the execution of the imprisonment sentence, even before the entry into force of the ruling which allows the repetition of the criminal procedure.</p>	<p style="text-align: center;">Član 29</p> <p style="text-align: center;">Odlaganje izvršenja kod primene vanrednih pravnih lekovima</p> <p>1. Sud koji odlučuje o zahtevu za ponavljanje krivičnog postupka podnetog u korist osuđenog lica može da odloži izvršenje kazne zatvora, čak i pre nego što rešenje kojim se dozvoljava ponavljanje krivičnog postupka stupi na snagu.</p>

<p>2. Gjykata që vendos lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit, varësisht nga përmbajtja e kërkesës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 30 Lejimi i shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim me kërkesë të Prokurorit të Shtetit</p> <p>1. Me kërkesë të Prokurorit të Shtetit kompetent gjithmonë lejohet shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim, derisa të merret vendimi për shfrytëzimin e mjetit juridik.</p> <p>2. Vendimi për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim pushon të vlej, nëse prokurori i shtetit nuk e shfrytëzon mjetin juridik brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i vendimit për shtyrjen e ekzekutimit.</p>	<p>2. The court that decides on the request for extraordinary mitigation of sentence may postpone the execution of the sentence, depending on the content of the request.</p> <p style="text-align: center;">Article 30 Granting of the postponement of the execution of the imprisonment sentence at the request of the State Prosecutor</p> <p>1. At the request of the competent State Prosecutor, the postponement the execution of the imprisonment sentence shall always be granted until a decision is made on the use of legal remedy.</p> <p>2. The decision to postpone the execution of the imprisonment sentence ceases to be valid, if the state prosecutor does not use the legal remedy within thirty (30) days from the receipt of the decision to postpone the execution.</p>	<p>2. Sud koji odlučuje o zahtevu za vanredno ublažavanje kazne može da odloži izvršenje kazne zatvora u zavisnosti od sadržine zahteva.</p> <p style="text-align: center;">Član 30 Odobrenje za odlaganje izvršenja kazne zatvora na zahtev državnog tužioca</p> <p>1. Na zahtev nadležnog državnog tužioca uvek se odobrava odlaganje izvršenja kazne zatvora do donošenja odluke o pravnom leku.</p> <p>2. Odluka o odlaganju izvršenja kazne zatvora prestaje da važi ako državni tužilac ne iskoristi pravni lek u roku od trideset (30) dana od prijema odluke o odlaganju izvršenja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 31 Pranimi i personit të dënuar në institucionin korrektues</p> <p>1. Kur personi i dënuar pranohet në institucionin korrektues, së pari vërtetohet identiteti i tij, baza dhe autorizimi për burgimin, ose burgimin e tij të përjetshëm</p>	<p style="text-align: center;">Article 31 Admission of the convicted person to the correctional facility</p> <p>1. When a convicted person is admitted to a correctional facility, his or her identity, grounds and authorization for imprisonment or life imprisonment, are first confirmed and</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Prijem osuđenog lica u kazneno-popravnu ustanovu</p> <p>1. Kada se osuđeno lice prima u kazneno popravnu ustanovu, prvo se utvrđuje njegov identitet, osnova i ovlašćenje za njegovu kaznu zatvora ili doživotnog zatvora, a zatim</p>

<p>dhe më pas i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda njëzetekatër (24) orëve nga pranimi i tij, apo në ditën e parë të punës pas pranimit. Emri i personit të dënuar, bazat dhe autorizimi për burgimin, ose burgimin e tij të përgjeshëm, data dhe koha e ardhjes së tij në institucionin korrektues, kontrolli dhe raporti mjekësor shënohet në regjistër dhe dosjen personale të dënuarit.</p> <p>2. Me rastin e pranimit në institucionin korrektues, personi i dënuar njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së denimit. Personi i dënuar i cili nuk dinë shkrim dhe lexim njoftohet gojarisht.</p> <p>3. Personave të dënuar me rastin e pranimit të tyre në institucion korrektues u lejohen gjësendet e caktuara në qelitë e tyre. Çdo gjësend i cili nuk lejohet në qelitë e tyre ose do të ruhet në depo të sigurta nga Shërbimi Korrektues deri në lirimin e personit të dënuar, ose mund t'i jepet një personi të tretë me kërkesën e të dënuarit.</p> <p>4. Institucioni korrektues i mundëson personit të dënuar kontakt të menjëhershëm me anëtarët e familjes pas pranimit të tij. Shtetasit të huaj i ofrohet mundësia që me shkrim, ose me telefon ta kontaktojnë</p>	<p>then the convicted person is subjected to a medical examination within twenty-four (24) hours of his or her admission, or on the first working day after the admission. The name of the convicted person, the grounds and authorization for imprisonment, or his life imprisonment, the date and time of his arrival in the correctional facility, the examination and the medical report shall be recorded in the register and personal file of the convicted person.</p> <p>2. Upon admission to the correctional facility, the convicted person shall be notified in writing of his or her rights and obligations while serving the sentence. The convicted person who is illiterate is notified orally.</p> <p>3. Convicted persons on the occasion of their admission to a correctional facility are allowed certain items in their cells. Anything that is not allowed in their cells will either be stored in secure warehouses by the Correctional Service until the convicted person is released, or may be given to a third person at the convicted person's request.</p> <p>4. The correctional facility provides the convicted person with immediate contact with family members upon his or her admission. Foreign nationals are offered the opportunity to contact in writing or by telephone the</p>	<p>se podvrgava lecarskom pregledu u roku od dvadeset i četiri (24) sata od dolaska ili prvog narednog radnog dana od dolaska u ustanovu. Ime osuđenog lica, osnova i ovlašćenje za njegovu kaznu zatvora ili doživotnog zatvora, datum i vreme dolaska u kazneno popravnu ustanovu, kontrola i lekarski izveštaj upisuju se u registar i lični dosije osuđenika.</p> <p>2. Prilikom prijema u kazneno popravnu ustanovu osuđeno lice biva obavješteno o pravima i obavezama koje ima tokom izdržavanja kazne, u pisanom obliku. Nepismeno osuđeno lice dobija te informacije usmeno.</p> <p>3. Prilikom njihovog prijema u kazneno-popravnu ustanovu osuđenim licima su dozvoljeni određeni predmeti u ćelijama. Sve što nije dozvoljeno u njihovim ćelijama, kazneno-popravna ustanova će čuvati u sigurnim skladištima dok osuđeno lice ne bude pušten na slobodu, ili na zahtev osuđeno lica može biti dato trećem licu.</p> <p>4. Kazneno-popravna ustanova omogućava osuđenom licu neposredan kontakt sa članovima porodice po njegovom prijemu. Stranim državljanima se pruža mogućnost pismenog ili telefonskog kontakta sa</p>
--	--	---

<p>përfaqësuesin diplomatik, apo zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai.</p> <p>5. Nëse personi i dënuar ka fëmijë të mitur, ose persona për të cilët ka përgjegjësi të veçantë për përkujdesje, institucioni korrektues lidhur me këtë e informon organin e kujdestarisë.</p> <p>6. Personi i dënuar me rastin e pranimit në Institucionin Korrektues duhet të fotofohet dhe ti hapet dosja personale.</p> <p>7. Pamja e personit të dënuar si në paragrafin 6 të këtij nenin duhet të jetë identike me fotografimin e dokumentit të identifikimit përjashtimisht fotografimi mund të ndryshohet varësisht prej ndryshimit pamjes fizike gjatë mbajtjes dënimit.</p> <p>8. Teksti i këtij ligji dhe akti nënligjor për rendin shtëpiak në institucionet korrektuese janë në dispozicion në gjuhë të personave të dënuar gjatë tërë kohës së mbajtjes së dënimit, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare.</p>	<p>diplomatic representative, or the relevant office of the state of which he is a national.</p> <p>5. If the convicted person has minor children, or persons for whom he/she has special responsibilities for care, the correctional facility shall inform the custodial body.</p> <p>6. The convicted person on the occasion of admission to the Correctional Institution must be photographed and his personal file opened.</p> <p>7. The appearance of the convicted person as in paragraph 6 of this article must be identical to the photograph of the identification document, exceptionally the photography can be changed depending on the change of physical appearance while serving the sentence.</p> <p>8. The text of this law and the bylaw on house order in correctional facilities are available in the language of convicted persons during the entire period of serving the sentence, in accordance with the law on the use of official languages.</p>	<p>diplomatskim predstavnikom ili odgovarajućom kancelarijom države čiji je državljanin.</p> <p>5. Ako osuđeno lice ima maloletnu decu ili lica za koja ima posebne odgovornosti za negu, kazнено-popravna ustanova će o tome obavestiti starateljski organ.</p> <p>6. Osuđeno lice prilikom prijema u KPU mora se fotografisati i njegov lični dosije mora biti otvoren.</p> <p>7. Izgled osuđenog lica kao u stavu 6. ovog člana mora biti identičan fotografiji ličnog dokumenta, izuzetno se fotografija može promeniti u zavisnosti od promene fizičkog izgleda tokom izdržavanja kazne.</p> <p>8. Tekst ovog zakona i podzakonskog akta o kućnom redu u kazнено-popravnim ustanovama dostupni su na jeziku osuđenog lica tokom celog perioda izdržavanja kazne, u skladu sa zakonom o upotrebi službenih jezika.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 32 Rendi shtëpiak</p>	<p align="center">Article 32 House order</p>	<p align="center">Član 32 Kućni red</p>
<p>1. Me aktin nënligjor për rendin shtëpiak në institucionet korrektuese (më tej: akti për rendin shtëpiak), të cilin e nxjerrë Ministri i Drejtësisë, rregullohet organizimi dhe mënyra e jetës së personave të dënuar dhe të personave të paraburgosur, e në veçanti:</p> <p>1.1 pranimi dhe vendosja;</p> <p>1.2 njohja me rendin shtëpiak dhe me dispozitat e tjera;</p> <p>1.3 ushqimi, mbrojtja shëndetësore dhe zbatimi i masave higjienike;</p> <p>1.4 mënyra e plotësimit të nevojave fetare;</p> <p>1.5 korrespondenca, pranimi i vizitave dhe i paketave;</p> <p>1.6 llojet dhe sasi të prodhimeve ushqimore të cilat mund të pranohen;</p> <p>1.7 kushtet dhe mënyra e disponimit me të hollat e fituara si kompensim për punë dhe shpërblimet;</p>	<p>1. The bylaw on house order in correctional institutions (hereinafter: the act on housekeeping), issued by the Minister of Justice, shall govern the organization and way of life of convicted persons and detainees, in particular:</p> <p>1.1 acceptance and placement;</p> <p>1.2 familiarity with house rules and other provisions;</p> <p>1.3 food, health protection and implementation of hygienic measures;</p> <p>1.4 the manner of meeting religious needs;</p> <p>1.5 correspondence, receiving visits and packages;</p> <p>1.6 types and quantities of food products that can be accepted;</p> <p>1.7 the conditions and manner of keeping the money earned as compensation for work and rewards;</p>	<p>1. Podzakonskim aktom o kućnom redu kazneno popravne ustanove (u daljem tekstu: akt o kućnom redu), koji donosi ministar pravde, uređuju se organizacija i način života osuđenih lica i pritvorenih lica, a naročito:</p> <p>1.1. prijem i smeštaj;</p> <p>1.2. upoznavanje sa kućnim redom i drugim pravilima;</p> <p>1.3. Ishrana, zdravstvena zaštita i sprovođenje mera higijene;</p> <p>1.4. Način zadovoljenja verskih potreba;</p> <p>1.5. Prepiska, prijem poseta i paketa;</p> <p>1.6. Vrsta i količina prehrambenih proizvoda koje sme da primi;</p> <p>1.7. Uslovi i način raspolaganja novcem dobijenim kao naknadu za rad i nagradu;</p>

<p>1.8. mënyra e shfrytëzimit të pushimit vjetor;</p> <p>1.9 mbajtja e rendit dhe disiplinës;</p> <p>1.10 sistemi i shkeljeve disiplinore dhe të sanksioneve;</p> <p>1.11. kushtet dhe mënyra e aplikimit të masave disiplinore, masave të vetmisë;</p> <p>1.12. llojet e beneficioneve, të kushteve dhe mënyrës së shfrytëzimit të të gjitha beneficioneve;</p> <p>1.13. organizimi i aktiviteteve kulturore, arsimore, sportive dhe argëtuese;</p> <p>1.14. qëndrimi në hapësirë të hapur;</p> <p>1.15. lirimi dhe ndihma me rastin e lirit nga mbajtja e dënimit me burg apo nga paraburgimi;</p> <p>1.16 përcaktimi i listës për gjësende të lejuara.</p> <p>1.17. çështjet e tjera të cilat janë me rëndësi për kushtet dhe mënyrën e mbajtjes së masës së dënimit me burgim dhe paraburgim.</p>	<p>1.8 the manner of using the annual leave;</p> <p>1.9 maintaining order and discipline;</p> <p>1.10 system of disciplinary violations and sanctions;</p> <p>1.11. conditions and manner of application of disciplinary measures, measures of solitary confinement;</p> <p>1.12. types of benefits, conditions and the manner of using all benefits;</p> <p>1.13. organization of cultural, educational, sports and entertainment activities;</p> <p>1.14. staying outdoors;</p> <p>1.15. release and assistance in case of release from serving a prison sentence or detention on remand;</p> <p>1.16 providing the list of permitted items.</p> <p>1:17. other issues which are important for the conditions and manner of serving the measure of imprisonment and detention on remand.</p>	<p>1.8. Način korišćenja godišnjeg odmora;</p> <p>1.9. Održavanje reda i discipline;</p> <p>1.10. Sistem disciplinskih prekršaja i sankcija;</p> <p>1.11. Uslovi i način primene disciplinskih mera, mera samice;</p> <p>1.12. Vrste privilegija, uslovi i način za korišćenje svih privilegija;</p> <p>1.13. Organizovanje kulturnih, nastavnih, sportskih i zabavnih aktivnosti;</p> <p>1.14. Boravak na otvorenom prostoru;</p> <p>1.15. Puštanje iz zatvora i pomoć prilikom oslobađanja od izdržavanja kazne zatvora ili pritvora;</p> <p>1.16. kreiranje liste dozvoljenih stvari</p> <p>1.17. Druga pitanja koja su od značaja za način izdržavanja kazne zatvora i mere pritvora..</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 33 Ndarja nga personat e dënuar</p>	<p align="center">Article 33 Separation from convicted persons</p>	<p align="center">Član 33 Odvajanje osuđenog lica</p>
<p>1. Me kërkesë të personit të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë që personi i dënuar të ndahet nga personat e tjerë të dënuar në një njësi të veçantë të institucionit korrektues, nëse drejtori konstaton se arsyet e paraqitura në kërkesën e personit të dënuar janë të arsyeshme dhe nuk ka mundësi të tjera për zgjidhjen e tyre.</p> <p>2. Drejtori i institucionit korrektues mund të urdhërojë që personi i dënuar të ndahet nga personat e tjerë të dënuar edhe pa kërkesën e personit të dënuar vetëm kur kjo masë është e nevojshme:</p> <p>2.1. për t'iu shmangur rrezikut për jetën, ose shëndetin e personit të dënuar, ose të ersonave të tjerë;</p> <p>2.2. për t'iu shmangur rrezikut të sigurisë në institucionin korrektues të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e personit të dënuar në mesin e të burgosurve dhe personave të tjerë të burgut, ose</p> <p>2.3. për të siguruar integritetin e hetimit të ndonjë çështjeje disiplinore.</p>	<p>1. At the request of the convicted person, the director of the correctional facility may allow the convicted person to be separated from other convicted persons in a separate unit of the correctional facility, if the director finds that the reasons set out in the convicted person's request are reasonable and there are no other options for resolving them.</p> <p>2. The director of the correctional facility may order that the convicted person be separated from other convicted persons even without the request of the convicted person only when this measure is necessary:</p> <p>2.1. to avoid endangering the life or health of the convicted person or other persons;</p> <p>2.2. to avoid the security risk in the correctional facility caused by the continued presence of the convicted person among the prisoners and other persons in prison, or</p> <p>2.3. to ensure the integrity of the investigation of any disciplinary matter.</p>	<p>1. Na zahtev osuđenog lica, direktor kazneno-popravne ustanove može da dozvoli osuđenom licu da bude odvojen od ostalih osuđenog lica u posebnoj jedinici kazneno-popravne ustanove, ako direktor utvrdi da su razlozi navedeni u zahtevu osuđenog lica opravdani i ne postoje druge mogućnosti za njihovo rešavanje.</p> <p>2. Direktor kazneno-popravne ustanove može da naloži da se osuđeno lice odvoji od ostalih osuđenih lica i bez molbe osuđenog lica samo ako je ta mera neophodna:</p> <p>2.1. da se izbegne opasnost po život ili zdravlja osuđenog lica ili drugih lica;</p> <p>2.2. da se izbegne pretnja po bezbednost kazneno-popravne ustanove zbog trajnog prisustva osuđenog lica među zatvorenicima i drugim licima u zatvoru, ili</p> <p>2.3. da se obezbedi integritet istrage u vezi nekog disciplinskog pitanja.</p>

<p>3. Vendimi nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni merret pas hetimit të të gjitha rrethanave relevante. Ndarja nuk mund të urdhërohet për një periudhë që i kalon tridhjetë (30) ditë. Vendimi i tillë rishikohet për aq sa ka nevojë, por të paktën një herë në dhjetë (10) ditë.</p>	<p>3. The decision from paragraphs 1 and 2 of this article is taken after the investigation of all relevant circumstances. Separation may not be ordered for a period exceeding thirty (30) days. Such decision shall be reviewed as necessary, but at least once every ten (10) days.</p>	<p>3. Odluka iz st. 1. i 2. ovog člana donosi se nakon istrage svih relevantnih okolnosti. Izdvajanje se ne može naložiti duže od trideset (30) dana. Takva odluka će se preispitati po potrebi, ali najmanje jednom u deset (10) dana.</p>
<p>4. Kur ndarja është urdhëruar për parandalimin e personit të dënuar për të mos ndikuar në personin tjetër të dënuar në shkëljen e rëndë të rendit brenda institucionit korrektues, ose për parandalimin e tij në kryerjen e aktivitetit të vazhdueshëm kriminal në institucionin korrektues, personi i dënuar mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit korrektues kur pritet që ndarja të zgjasë shumë.</p>	<p>4. When the separation is ordered to prevent the convicted person from influencing the other convicted person in a serious breach of order within the correctional facility, or to prevent him from committing continued criminal activity in the correctional facility, the convicted person may be placed in a separate unit of the correctional facility when the separation is expected to last a long time.</p>	<p>4. Kada je odvajanje naloženo radi sprečavanja osuđenog lica da navede drugog osuđenika na težu povredu reda u kazneno popravnoj ustanovi ili radi njegovog sprečavanja na dalje vršenje kriminalnih aktivnosti u kazneno popravnoj ustanovi, osuđeno lice može da bude smešteno u specijalnu jedinicu kazneno popravne ustanove kada se očekuje da to odvajanje potraje duže.</p>
<p>5. Drejtori i institucionit korrektues mund të urdhërojë ndarjen e personit të dënuar i cili sillet në mënyrë të dhunshme nga personat tjerë të dënuar pa kërkesën e tij, për aq sa është e nevojshme të pengojë sjelljen e tij të dhunshme.</p>	<p>5. The director of the correctional facility may order the separation of a convicted person who behaves violently from other convicted persons without /her request, insofar as it is necessary to prevent his/her violent behavior.</p>	<p>5. Direktor kazneno popravne ustanove može da naredi da osuđeno lice koje se ponaša nasilno prema drugima bude odvojen bez njegovog zahteva, onoliko dugo koliko bude potrebno da se obuzda njegovo nasilno ponašanje.</p>
<p>6. Personit të dënuar, të ndarë prej personave të tjerë të dënuar i njihen të njëjtat të drejta, benificione dhe kushte sikurse ato të cilat i gëzojnë të gjithë të burgosurit, përveç atyre benificioneve të cilat mund të gëzohen vetëm bashkërisht me të burgosurit tjerë, apo të cilat nuk mund të sigurohen për shkak të</p>	<p>6. The convicted person, separated from other convicted persons, shall be granted the same rights, benefits and conditions as those enjoyed by all prisoners, except for those benefits which may be enjoyed only jointly with other prisoners, or which can not be provided due to the limitations of the units of</p>	<p>6. Osuđeno lice odvojeno od ostalih osuđenih lica ima ista prava, privilegije i uslove jednake onima koje uživaju svi drugi zatvorenici u kazneno popravnoj ustanovi, osim onih privilegija koje može da uživa samo zajedno sa ostalim zatvorenicima ili onih koje mu se ne mogu omogućiti zbog</p>

<p>kufizimeve që i kanë njësitë e institucionit korrektues në të cilin është vendosur personi i dënuar i ndarë.</p> <p>7. Personeli i kualifikuar shëndetësor e kontrollon personin e dënuar të ndarë, së paku një herë në ditë dhe sipas nevojës.</p> <p>8. Vendimi për ndarjen e personit të dënuar nga personat e tjerë të dënuar ndërpritet posa të pushojnë së ekzistuari arsyet për urdhërimin e ndarjes, ose në rastet kur personeli i kualifikuar shëndetësor konstaton se vazhdimi i ndarjes do të jetë i dëmshëm për shëndetin e personit të dënuar.</p>	<p>the correctional facility in which the separated convicted person is placed.</p> <p>7. Qualified health personnel shall check the separated convicted person at least once a day and as needed.</p> <p>8. The decision to separate the convicted person from other convicted persons is terminated as soon as the reasons for ordering the separation cease to exist, or in cases when qualified health personnel find that the continuation of the separation will be harmful to the health of the convicted person.</p>	<p>postojecih ograničenja u jedinici kazneno popravne ustanove u koju je smešteno odvojeno osuđeno lice.</p> <p>7. Kvalifikovano zdravstveno osoblje vrši pregled odvojenog osuđenog lica najmanje jednom dnevno i prema potrebi.</p> <p>8. Odluka o odvajanju osuđenog lica od ostalih osuđenika ukida se čim prestanu da postoje razlozi zbog kojih je odvajanje naređeno ili kad kvalifikovano zdravstveno osoblje utvrdi da bi dalje odvajanje bilo štetno po zdravlje osuđenog lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 34 Kontrollimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Searches</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Pretnes</p>
<p>1. Personi i dënuar nuk duhet të kontrollohet në mënyrën e cila e cenon dinjitetin e tij. Shkalla e shqetësimit së personit të dënuar gjatë kontrollimit duhet të jetë proporcionale me qëllimin e tij, ashtu siç është paraparë me këtë nen.</p> <p>2. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar ka nëposedim ndonjë mjet, i cili atij nuk i lejohet ta ketë në posedim në pajtim me rregullat për rendin e brendshëm konsiderohet si mjet i palejuar, personi i dënuar mund të kontrollohet me dorë, ose me</p>	<p>1. The convicted person shall not be searched in a way that violates his dignity. The level of harassing the convicted person during the search must be proportionate to his intent, as provided by this article.</p> <p>2. If the member of the correctional staff has a reasonable suspicion that the convicted person is in possession of an implement which he is not allowed to possess in accordance with the rules of internal order, and is considered an impermissible implement, the convicted person may be</p>	<p>1. Način pretresa osuđenog lica ne sme da narušava njegovo dostojanstvo. Stepem uznemiravanja pretresa osuđenog lica treba da bude proporcionalna njegovoj svrsi kako je propisano ovim članom.</p> <p>2. Ako član osoblja kazneno popravne ustanove opravdano posumnja da osuđeno lice poseduje neki predmet čije mu posedovanje nije dozvoljeno shodno pravilima o unutrašnjem redu, i smatra se nedozvoljen predmet, osuđeno lice može da se pretrese ručno ili tehničkim sredstvom dok</p>

<p>mjete teknike derisa është i veshur. Kontrollimi me dorë duhet të bëhet nga anëtarë të personelit korrektues të së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar.</p> <p>3. Anëtarë të personelit korrektues mund të kontrollojnë trupin e zhveshur të personit të dënuar përmes inspektimit vizuel kur nuk ekziston ndonjë dyshim i veçantë në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6. të këtij neni:</p> <p>3.1. në rrethanat e përcaktuara, të parapara në urdhëresë të kufizuara në situata ku personi i dënuar ka qenë në vend ku ka pasur gjasa të ketë qasje në mjetin e palejuar që ka mundësi të fshehët brenda ose jashtë trupit;</p> <p>3.2. kur personi i dënuar hyn, apo del nga lokalet e personave të dënuar të ndarë.</p> <p>4. Nëse tek anëtarë të personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar është në posedim të ndonjë mjeti të palejuar dhe e ka bindur drejtorin e institucionit korrektues se kontrolli i trupit të zhveshur të personit të dënuar me inspektim vizuel është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, kontrolli i tillë mund të bëhet në</p>	<p>hand-checked, or by technical means while dressed. The manual search must be performed by a member of the correctional staff who is of the same sex as the convicted person.</p> <p>3. A member of the correctional staff may inspect the naked body of a convicted person through visual inspection when there is no particular suspicion in accordance with the conditions set forth in paragraph 6 of this article:</p> <p>3.1. in the circumstances set forth in the order, which are restricted in situations where the convicted person has been in a place where he was likely to have access to an unauthorized implement that may be hidden inside or outside the body;</p> <p>3.2. when the convicted person enters or leaves the premises of separated convicted persons.</p> <p>4. If the member of the correctional staff has a reasonable suspicion that the convicted person is in possession of an unauthorized vehicle and has convinced the director of the correctional facility that the examination of the naked body of the convicted person by visual inspection is necessary to find the unauthorized implement, such search may be</p>	<p>je odeveno. Ručni pretres vrši član osoblja kazneno popravne ustanove istog pola kao osuđeno lice.</p> <p>3. Član osoblja kazneno popravne ustanove može da izvrši pretres vizuelnim pregledom golog tela osuđenog lica i kad nema posebnih sumnji, u skladu sa uslovima predviđenim u stavu 6 ovog člana:</p> <p>3.1. u propisanim uslovima utvrđenim naredbom, ograničenim na situacije u kojima je osuđeno lice bilo na mestu na kojem je moglo da ima pristup nedozvoljenom predmetu koji može da se sakrije unutar ili izvan tela</p> <p>3.2. kad osuđeno lice ulazi ili izlazi u prostor sa odvojenim osuđenim licima.</p> <p>4. Ako član osoblja kazneno popravne ustanove opravdano posumnja da osuđeno lice poseduje neki nedozvoljeni predmet i uveri direktora kazneno popravne ustanove da je potreban pretres golog tela osuđenog lica putem vizuelne inspekcije radi pronalaženja nedozvoljenog predmeta, takav</p>
---	--	--

<p>pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6. të këtij neni.</p> <p>5. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar posedon ndonjë mjet të palejuar dhe se kontrolli i trupit të zhveshur të personit të dënuar me inspektim vizuel është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, ai mund të kryejë kontrollin e tillë në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6. të këtij neni pa miratim paraprak të drejtorit të institucionit korrektuese nëse vonesa për kërkimin e miratimit të tillë do të rezultonte me rrezik për jetën, apo sigurinë e njeriut.</p> <p>6. Kontrolli i trupit të zhveshur të personit të dënuar me kontrollim vizuel:</p> <p>6.1. bëhet nga ana e dy (2) punonjësve korrektues të së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar dhe në një vend të veçuar, pa praninë e personave të tjerë;</p> <p>6.2. asnjëherë nuk bëhet në praninë e personave të gjinisë tjetër nga ajo e personit të dënuar; dhe</p> <p>6.3. nuk përfshin zhveshjen e pjesëve të sipërme dhe të poshtme të trupit të personit të dënuar në të njëjtën kohë.</p>	<p>carried out in accordance with the conditions set forth in paragraph 6 of this article.</p> <p>5. If the member of the correctional staff has a reasonable suspicion that the convicted person possesses an unauthorized implement and that the inspection of the naked body of the convicted person by visual inspection is necessary to find the unauthorized implement, he may carry out such inspection in accordance with the conditions set forth in paragraph 6 of this article without the prior approval of the director of the correctional facility if the delay in seeking such approval would result in a risk to human life or safety.</p> <p>6. Examination of the naked body of the convicted person by visual inspection:</p> <p>6.1. is carried out by two (2) correctional workers of the same sex as that of the convicted person and in a separate place, without the presence of other persons;</p> <p>6.2. is never carried out in the presence of persons of the opposite sex from that of the convicted person; and</p> <p>6.3. does not involve undressing the upper and lower body parts of the convicted person at the same time.</p>	<p>pretres može da se izvrši pod uslovima utvrđenim u stavu 6 ovog člana.</p> <p>5. Ako član osoblja kazneno popravne ustanove opravdano posumnja da osuđeno lice poseduje neki nedozvoljeni predmet i da je potreban pretres vizuelnom inspekcijom golog tela osuđenog lica da bi se pronašao nedozvoljeni predmet, on može da izvrši takav pretres u skladu sa uslovima utvrđenim u stavu 6 ovog člana, bez prethodnog odobrenja direktora kazneno popravne ustanove, ako bi odlaganje uzrokovano traženjem tog odobrenja dovelo do opasnosti po život ili bezbednost ljudi.</p> <p>6. Pretres vizuelnom inspekcijom golog tela osuđenog lica:</p> <p>6.1. vrše dva (2) radnika kazneno popravne ustanove istog pola kao osuđeno lice i u posebnoj prostoriji bez prisustva ostalih lica;</p> <p>6.2. nikad ne sme da se vrši u prisustvu lica različitog pola od pola osuđenog lica; i</p> <p>6.3. ne uključuje istovremeno razodevanje gornjih i donjih delova tela osuđenog lica.</p>
--	--	--

<p>7. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar posedon ndonjë mjet të palejuar të fshehur në zgavrat e trupit të tij, ai e informon drejtorin e institucionit korrektues. Nëse drejtori i institucionit korrektues është i bindur se ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar është në posedim të ndonjë mjete të palejuar të fshehur në zgavrat e trupit të tij dhe se kontrollimi fizik i zgavrave të trupit të tij është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, drejtori mund të lëshojë autorizim me shkrim për kontrollimin e tillë fizik, me pëlqimin e personit të dënuar. Kontrollimi i tillë fizik kryhet vetëm nga ana e personelit të kualifikuar shëndetësor i së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar në një vend të veçuar.</p> <p>8. Çfarëdo mjeti i palejuar i cili zbulohet si rezultat i kontrollimit, ose kontrollimit fizik të zgavrave tëtrupi mund të konfiskohet.</p> <p>9. Kontrollimi i qelisë së burgut të personit të dënuar ose të paraburgosurit duhet të kryhet me respektimin e pasurisë së tij personale dhe në prani të të dënuarit ose të paraburgosurit, përvec nëse prania e tyre do të paraqiste një kërcënim të menjëhershëm për stafin ose sigurinë e objektit.</p>	<p>7. If the member of the correctional staff has a reasonable suspicion that the convicted person possesses an unauthorized implement hidden in the cavities of his body, he shall inform the director of the correctional facility. If the director of the correctional facility is convinced that there is a reasonable suspicion that the convicted person is in possession of an unauthorized implement hidden in the cavities of his body and that a physical search of the cavities of his body is necessary to find the unauthorized implement, the director may issue a written authorization for such physical search, with the consent of the convicted person. Such physical search is carried out only by qualified health personnel of the same sex as that of the convicted person in a secluded place.</p> <p>8. Any unauthorized implement which is discovered as a result of the inspection, or physical inspection of the body cavities may be confiscated.</p> <p>9. The search of the prison cell of the convicted person or of the detainee, shall be carried out by respecting his personal property and in the presence of the convicted person or of the detainee, unless their presence would pose an immediate threat to the staff or security of the facility.</p>	<p>7. Ako član osoblja kazneno popravne ustanove opravdano posumnja da osuđeno lice poseduje nedozvoljeni predmet skriven u telesnim šupljinama, o tome obaveštava direktora kazneno popravne ustanove. Ako se direktor kazneno popravne ustanove uveri da postoji osnovana sumnja da osuđeno lice drži nedozvoljeni predmet skriven u svojim telesnim šupljinama i da je potrebno fizičko ispitivanje njegovih telesnih šupljina da bi se našao nedozvoljeni predmet, direktor može da izda pisano ovlašćenje za takav fizički pretres uz saglasnost osuđenog lica. Takav fizički pretres vrši samo kvalifikovano zdravstveno osoblje istog pola kao i osuđeno lice, u posebnoj prostoriji.</p> <p>8. Svaki nedozvoljeni predmet otkriven prilikom pretresa ili fizičkog pretresa telesnih šupljina može da se oduzme.</p> <p>9. Pretres zatvorske ćelije osuđenog pritvorenog lica izvršiće se uz poštovanje njegove lične imovine i u prisustvu osuđenog lica ili pritvorenika, osim ako bi njihovo prisustvo predstavljalo neposrednu pretnju za osoblje ili bezbednost objekta.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 35 Kushtet e banimit për personat e dënuar</p>	<p align="center">Article 35 Dwelling conditions of convicted persons</p>	<p align="center">Član 35 Uslovi boravišta osuđenih lica</p>
<p>1. Personi i dënuar ka të drejtë në banimit që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.</p> <p>2. Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.</p> <p>3. Lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.</p> <p>4. Në lokale të përbashkëta vendosen personat e dënuar të cilët janë të përshtatshëm për t'u shoqëruar me të tjerët në kushtet e tilla.</p>	<p>1. The convicted person has the right to dwelling that meets modern hygienic conditions and local climatic circumstances.</p> <p>2. The premises in which the convicted person lives and works must have sufficient space so that each convicted person has at least eight (8) square meters of space for a single cell and four (4) square meters for convicted persons in joint cells, and sufficient amounts of natural and artificial light for work and reading, heating and ventilation.</p> <p>3. Premises shall not have moisture and shall have adequate sanitary facilities and other personal hygiene items.</p> <p>4. Convicted persons who are suitable to associate with others in such conditions are placed in joint premises.</p>	<p>1. Osuđeno lice ima pravo na boravište u skladu sa savremenim higijenskim uslovima i lokalnim klimatskim prilikama.</p> <p>2. Prostorije u kojima osuđeno lice živi i radi moraju da budu dovoljno prostrane da svako osuđeno lice ima na raspolaganju najmanje osam (8) kubnih metara prostora i a četiri (4) kvadratnih metara za osuđenike u samici i dovoljno prirodno i veštačko osvetljenje za rad i čitanje, kao i grejanje i ventilaciju.</p> <p>3. Prostorije ne smeju da budu vlažne i moraju da imaju adekvatne sanitarne instalacije i ostale uređaje neophodne za ličnu higijenu.</p> <p>4. U zajedničke prostorije smeštaju se osuđena lica koja su primerena za druženje sa drugima pod tim uslovima.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 36 Marrja me ushtrime fizike</p> <p>Personi i dënuar ka të drejtë që të merret me ushtrime fizike aq sa është e nevojshme për ruajtjen e shëndetit të tij dhe të kalojë së paku dy (2) orë në ditë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë. Nëse moti është i mirë, personi i dënuar mund të merret me ushtrime fizike në ambient të hapur.</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 Exercising</p> <p>The convicted person has the right to engage in physical exercise to the extent necessary to maintain his health and to spend at least two (2) hours a day outside the closed premises during his free time. If the weather is good, the convicted person can engage in outdoor exercise.</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Obavljanje fizičkih vežbi</p> <p>Osuđeno lice ima pravo da fizički vežba u meri potrebnoj za održavanje svog zdravlja i da provede najmanje dva (2) sata dnevno van zatvorenog prostora u slobodnom vremenu. Ako vremenski uslovi dozvoljavaju, osuđeno lice može da se bavi fizičkim vežbama na otvorenom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 167 Mënyra e ekzekutimit të trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm për kryerësit e varur nga droga apo alkooli</p> <p>1. Masa e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm për kryerësit e varur nga droga, apo alkooli ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor, apo në institucionin tjetër përkatës. Nëse kjo masë shqiptohet së bashku me dënimin me burgim ajo mbahet në institucionin shëndetësor.</p>	<p style="text-align: center;">Article 167 The manner of execution of compulsory rehabilitation treatment for perpetrators addicted to drugs or alcohol</p> <p>1. The measure of compulsory rehabilitation treatment for perpetrators addicted to drugs or alcohol is executed in the health care institution, or in another relevant institution. If this measure is imposed together with the imprisonment, it is applied in the health institution.</p>	<p style="text-align: center;">Član 167 Način izvršenja obaveznog rehabilitacionog lečenja zavisnika od droge ili alkohol</p> <p>1. Mera obaveznog rehabilitacionog lečenja izvršilaca koji su zavisnici od droge ili alkohola izvršava se u zdravstvenoj ustanovi ili u drugoj odgovarajućoj ustanovi. Ako je mera izrečena kao dopunska zatvorskoj kazni, biće odslužena u zdravstvenoj ustanovi.</p>

<p>2. Gjykata vendos për institucionin e kujdesit shëndetësor, për institucionin korrektues, apo institucionin tjetër përkatës ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm.</p> <p>3. Kur gjykata shqipton masën e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm, ajo menjëherë ia dërgon vendimin dhe të gjitha të dhënat tjera që i posedon për shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit të kujdesit shëndetësor, institucionit korrektues, ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase.</p> <p>4. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata gjithashtu ia dërgon vendimin qendrës së paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i qendrës së paraburgimit e liron personin e dënuar për ekzekutimin e kësaj mase.</p>	<p>2. The court shall decide on the health care institution, the correctional facility, or other relevant institution where the measure of compulsory treatment should be executed.</p> <p>3. When the court imposes the measure of compulsory rehabilitation treatment, it shall immediately send the decision and all other data it possesses to the competent probation service and the health care institution, correctional institution, or relevant institution for the execution of this measure.</p> <p>4. If the convicted person is being held in detention on remand, the court shall also send the decision to the detention center where he is being held. The director of the detention center releases the person convicted for the execution of this measure.</p>	<p>2. Sud odlučuje o zdravstvenoj ustanovi, kazneno popravnoj ustanovi ili o drugoj odgovarajućoj ustanovi u kojoj treba da se izvrši mera obaveznog lečenja.</p> <p>3. Kada sud izrekne meru obaveznog rehabilitacionog lečenja, odmah šalje odluku i sve podatke koje poseduje nadležnoj službi za uslovnu slobodu i nadležnoj zdravstvenoj ustanovi, kazneno popravnoj ustanovi ili odgovarajućoj ustanovi radi izvršenja ove mere.</p> <p>4. Ako je osuđeno lice u pritvoru, sud šalje odluku i pritvorskoj instituciji u kojoj se nalazi osuđeno lice. Direktor pritvorske institucije otpušta osuđeno lice radi izvršenja ove mere.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 168 Programi i trajtimit të rehabilitimit</p> <p>1. Institucioni shëndetësor, institucioni korrektues, apo institucioni përkatës, në bashkëpunim me shërbimin sprovues cakton programin e trajtimit të rehabilitimit për personin që i nënshtrohet masës së trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm. Shërbimi sprovues mbikëqyrë nëse personi vepron në përputhje me programin e trajtimit rehabilitues, në bashkëpunim me</p>	<p style="text-align: center;">Article 168 Rehabilitation treatment program</p> <p>1. The health institution, correctional institution, or relevant institution, in cooperation with the probation service, determines the rehabilitation treatment program for the person who undergoes the measure of compulsory rehabilitation treatment. The probation service shall supervise whether the person acts in accordance with the rehabilitation treatment</p>	<p style="text-align: center;">Član 168 Program rehabilitacionog lečenja</p> <p>1. Nadležna zdravstvena ustanova, kazneno popravna ustanova ili odgovarajuća ustanova, u saradnji sa službom za uslovnu slobodu, određuje program rehabilitacionog lečenja za lice koje podleže meri obaveznog rehabilitacionog lečenja. Služba za uslovnu slobodu nadgleda pridržavanje tog lica programu rehabilitacije, u saradnji sa nadležnom zdravstvenom ustanovom,</p>

<p>institucionin shëndetësor, institucionin korrektues, apo institucionin përkatës.</p> <p>2. Shërbimi sprovues i dërgon çdo dy (2) muaj raport gjykatës për përparimin e arritur në programin e trajtimit rehabilitues bazuar në informatat e siguruara nga institucioni shëndetësor, i institucionit korrektues, apo i institucionit tjetër përkatës.</p> <p>3. Institucioni shëndetësor, institucioni korrektues, apo institucioni përkatës menjëherë e informojnë shërbimin sprovues nëse personi i dënuar nuk i përmbahet programit të trajtimit rehabilitues. Mos përmbushja e programit të trajtimit rehabilitues nga personi i dënuar vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës.</p> <p>4. Përfundimi i suksesshëm i programit të trajtimit rehabilitues i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas marrjes së raportit të tillë gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e masës së tillë.</p>	<p>program, in cooperation with the health institution, correctional institution, or relevant institution.</p> <p>2. The probation service shall send every two (2) months a report to the court on the progress achieved in the rehabilitation treatment program based on the information provided by the health institution, the correctional institution, or another relevant institution.</p> <p>3. The health institution, correctional facility, or relevant institution shall immediately inform the probation service if the convicted person does not adhere to the rehabilitation treatment program. Failure to complete the rehabilitation treatment program by the convicted person is assessed by the probation service and reported to the court.</p> <p>4. Successful completion of the rehabilitation treatment program is reported to the court by the probation service. After receiving such a report, the court makes a decision confirming the retention of such measure.</p>	<p>kazнено поправном установом или одговарајућом установом.</p> <p>2. Svaka dva meseca služba za uslovnu slobodu šalje izveštaj sudu o napretku ostvarenom u programu rehabilitacionog lečenja na osnovu informacija koje obezbedi nadležna zdravstvena ustanova, kazнено поправна ustanova или друга одговарајућа ustanova.</p> <p>3. Nadležna zdravstvena ustanova, kazнено поправна ustanova или одговарајућа ustanova одмах извештава службу за условну слободу ако се осуђено лице не придржава програма реабилитационог леčenja. Nepridržavanje осуђеног лица програма реабилитационог леčenja проценjuje служба за условну слободу i o tome извештава суд.</p> <p>4. O uspešnom okončanju programa rehabilitacionog lečenja Služba za uslovnu slobodu извештава суд. Nakon prijema tog извештаја суд donosi odluku којом utvrđuje da je mera одслужена.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 169 Mënyra e ekzekutimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor</p>	<p align="center">Article 169 Manner of execution of the measure of compulsory psychiatric treatment with custody in health care institution</p>	<p align="center">Član 169 Način izvršenja mere za obavezno psihiatrijsko lečenje uz zadržavanje u zdravstvenoj instituciji</p>
<p>1. Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ekzekutohet në institucionin shëndetësor, ose në institucionin tjetër të posaçëm që ndodhet në vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e të pandehurit, ose nëse institucioni i tillë nuk ndodhet në atë vend, në institucionin më të përafërt me vendin ku i pandehuri ka vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin, ose në vendin ku është zbatuar procedura penale.</p> <p>2. Gjykata vendos për institucionin shëndetësor, ose institucionin tjetër përkatës ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Me rastin e vendosjes për institucionin e kujdesit shëndetësor gjykata merr parasysh rrezikun që i pandehuri paraqet për mjedisin e tij, për vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e tij dhe nevojat e tij për trajtim.</p> <p>3. Kur gjykata cakton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, ajo menjëherë ia dërgon vendimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues</p>	<p>1. Compulsory psychiatric treatment with custody is executed in the health institution, or in another special institution located in the permanent residence, or residence of the defendant, or if such institution is not located in that location, in the institution closest to the location where the defendant has a permanent residence, or place of residence, or at the place where the criminal proceedings were conducted.</p> <p>2. The court shall decide on the health institution, or other relevant institution where the measure of compulsory psychiatric treatment with custody shall be executed. When deciding on a health care institution, the court takes into account the risk that the defendant poses to his environment, his permanent residence, or his place of residence and his needs for treatment.</p> <p>3. When the court imposes the measure of compulsory psychiatric treatment with custody, it shall immediately send the decision and all the data in its possession to</p>	<p>1. Mere obaveznog psihijatrijskog lečenja zadržavanjem izvršavaju se u zdravstvenoj instituciji ili drugoj posebnoj instituciji koja se nalazi u mestu stalnog boravka ili stanovanja optuženog, ili ako nema takve institucije u tom mestu, u instituciji najbližoj mestu gde optuženi ima stalno mesto boravka ili stanovanja ili u mestu gde je izvršen krivični postupak.</p> <p>2. Sud odlučuje o zdravstvenoj instituciji ili drugoj nadležnoj instituciji u kojoj će se izvršiti mera obaveznog psihijatrijskog lečenja uz zadržavanje. Prilikom smeštaja u zdravstvenu instituciju, sud uzima u obzir opasnost koju optuženi predstavlja za svoju sredinu, njegovo stalno mesto boravka ili stanovanja kao i njegove potrebe za tretmanom.</p> <p>3. Kada sud odredi meru obaveznog psihijatrijskog lečenja uz zadržavanje, odmah dostavlja presudu sa svim raspoloživim podacima nadležnoj kazneno</p>

<p>kompetent dhe institucionit shëndetësor, institucionit korrektues, ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase.</p> <p>4. Nëse masa është caktuar së bashku me dënimin me burgim, kryerësi i veprës penale së pari dërgohet në institucionin e kujdesit shëndetësor për trajtim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 170 Transferimi i personit të cilit i është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor</p> <p>1. Nëse personi ndaj të cilit është caktuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, me ndalim ndodhet në liri, gjykata urdhëron transferimin e tij në institucionin e kujdesit shëndetësor, ose urdhëron lëshimin e letër rreshtimit, por nëse personi ndodhet në paraburgim, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës e përcjell në institucionin e kujdesit shëndetësor.</p> <p>2. Personi ndaj të cilit është caktuar kjo masë, transferohet në institucionin e kujdesit shëndetësor I shoqëruar nga punëtorët e kujdesit shëndetësor.</p>	<p>the competent probation service and the health institution, correctional institution, or relevant institution for the execution of this measure.</p> <p>4. If the measure is imposed together with the imprisonment sentence, the perpetrator is first sent to the health care institution for treatment.</p> <p style="text-align: center;">Article 170 Transfer of the person to whom the measure of compulsory psychiatric treatment at liberty with custody in a health care institution has been imposed</p> <p>1. If the person to whom the measure of compulsory psychiatric treatment with custody has been imposed is at liberty, the court shall order his transfer to the health care institution, or shall order the issuance of a warrant, but if the person is in detention, the staff of Kosovo correctional service shall accompany him to the health care institution.</p> <p>2. The person to whom this measure is imposed, is transferred to the health care institution accompanied by health care employees.</p>	<p>popravnog službi i zdravstvenoj instituciji, kazneno popravnog instituciji ili nadležnoj instituciji za izvršenje ove mere.</p> <p>4. Ako je izrečena mera određena zajedno sa zatvorskom kaznom, izvršilac krivičnog dela prvo se šalje u zdravstvenu instituciju na lečenje.</p> <p style="text-align: center;">Član 170 Transfer lica kome je određena mera obaveznog psihijatrijskog lečenja zadržavanjem u instituciji zdravstvene nege</p> <p>1. Ako se lice prema kome je određena mera obaveznog psihijatrijskog tretmana uz zadržavanje nalazi na slobodi, sud naređuje njegov transfer u zdravstvenu instituciju ili naređuje izdavanje poternice, ali ako se lice nalazi u pritvoru, osoblje Kazneno popravnog službe Kosova upućuje ga u zdravstvenu instituciju.</p> <p>2. Lice kome je izrečena ova mera prebacuje se u zdravstvenu instituciju u pratnji zdravstvenih radnika.</p>
--	--	--

<p>3. Personi ndaj të cilit ekzekutohet kjo masë ka të drejta dhe detyrime të njëjta sikurse person i cili mban dënimin me burgim, nëse nevojat e trajtimit nuk kërkojnë ndryshe.</p> <p>4. Me propozimin e institucionit të kujdesit shëndetësor ku ekzekutohet kjo masë, gjykata gjatë kohëzgjatjes së masës, mund të vendosë për transferimin e personit nga një institucion i kujdesit shëndetësor në tjetrin.</p> <p>5. Gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë monitoron ligjshmërinë e ekzekutimit të saj. Organi publik kompetent për shëndetësi monitoron aftësinë profesionale të trajtimit, i cili ofrohet gjatë ekzekutimit të masës.</p>	<p>3. The person against whom this measure is executed has the same rights and obligations as a person serving a prison sentence, unless the needs of treatment require otherwise.</p> <p>4. Upon the proposal of the health care institution where this measure is executed, for the duration of the measure the court may decide on the transfer of the person from one health care institution to another.</p> <p>5. The court which imposed the measure in the first instance shall monitor the legality of its execution. The public body competent for health shall monitor the professional treatment ability, which is provided during the execution of the measure.</p>	<p>3. Lice prema kome se izvršava ova mera ima jednaka prava i obaveze kao i lice koje odsluži zatvorsku kaznu, osim ako potrebe njegovog tretmana ne zahtevaju nešto drugo.</p> <p>4. Na predlog zdravstvene institucije u kojoj se izvršava ova mera, sud u toku trajanja mere može da odluči o prebacivanju lica iz jedne zdravstvene institucije u drugu.</p> <p>5. Sud koji je naložio prvostepenu meru, prati zakonitost njenog sprovođenja. Javni organ nadležan za zdravstvo prati profesionalnu sposobnost tretmana koja se pruža u toku izvršenja mere.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 171 Raportimi i institucioni të kujdesit shëndetësor</p>	<p style="text-align: center;">Article 171 Reporting to the health care institution</p>	<p style="text-align: center;">Član 171 Izveštaj institucije za zdravstvenu zaštitu</p>
<p>1. Institucioni i kujdesit shëndetësor i dërgon gjykatës që ka caktuar masën në shkallë të parë raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit ekzekutohet masa, së paku një herë në gjashtë (6) muaj dhe më shpesh me kërkesë të gjykatës.</p> <p>2. Kur institucioni i kujdesit shëndetësor, ose mjeku përgjegjës për shërimin mendor</p>	<p>1. The health care institution shall send a report to the court that imposed the measure in the first instance on the state of health and success of the treatment of the person against whom the measure is executed, at least once every six (6) months and more often at the request of the court.</p> <p>2. When the health care institution, or the doctor responsible for mental treatment, finds</p>	<p>1. Zdravstvena institucija dostavlja sudu koji je naložio prvostepenu meru izveštaj o zdravstvenom stanju i uspehu tretmana lica prema kome se vrši ta mera, najmanje jednom u šest (6) meseci, ali i češće na zahtev suda.</p> <p>2. Kad zdravstvena institucija ili nadležni lekar za mentalno zdravlje konstatuje da više</p>

<p>konstaton se, më nuk është e nevojshme ta trajtojë, ose ta ndalojë kryerësin e veprës penale në institucionin e kujdesit shëndetësor, ai menjëherë e informon gjykatën që e ka caktuar masën në shkallë të parë.</p> <p>3. Çdo gjashtë (6) muaj, gjykata që ka caktuar masën në shkallë të parë, e shqyrton nevojën e vazhimit të masës pas shqyrtimit të institucionit shëndetësor dhe të mendimit të ekspertit të pavarur, i cili nuk është i punësuar në institucionin e kujdesit shëndetësor ku është duke u ekzekutuar masa.</p> <p>4. Sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e të pandehurit, mbrojtësit të institucionit të kujdesit shëndetësor, ose të organit të kujdestarisë që është kompetent në bazë të vendbanimit të përkohshëm, ose të përhershëm të personit në kohën kur ka hyrë në fuqi urdhri me anë të cilit është caktuar masa, gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë e pushon masën nëse konstaton se më nuk është e nevojshme që kryerësi të trajtohet, ose ndalohet në atë institucion. Kur pushon masën, gjykata mund ta caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm në liri nëse ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë.</p>	<p>that it is no longer necessary to treat or detain the perpetrator in the health care institution, the court that has imposed the measure in the first instance shall be immediately informed.</p> <p>3. Every six (6) months, the court that has imposed the measure in the first instance, shall review the need to continue the measure after the review by the health institution and the opinion of the independent expert, who is not employed in the health care institution where the measure is being executed.</p> <p>4. Ex officio, or on the proposal of the defendant, counsel of the health care institution or the custodial body that is competent on the basis of the temporary or permanent residence of the person at the time when the order imposing the measure entered into force, the court which has imposed the measure in the first instance shall terminate the measure if it finds that it is no longer necessary for the perpetrator to be treated, or detained in that institution. When the measure ceases, the court may impose the measure of compulsory treatment at liberty if there are reasons for imposing such a measure.</p>	<p>nema potrebe za tretmanom ili za zadržavanjem izvršioca krivičnog dela u zdravstvenoj instituciji, odmah o tome obaveštava sud koji je odredio prvostepenu meru.</p> <p>3. Svakih šest (6) meseci sud koji je odredio prvostepenu meru razmatra potrebu nastavka mere nakon razmatranja u zdravstvenoj instituciji i mišljenja nezavisnog stručnjaka, koji nije zaposlen u zdravstvenoj instituciji u kojoj se izvršava izrečena mera.</p> <p>4. Po službenoj dužnosti ili na predlog optuženog, branioca, zdravstvene institucije ili organa starateljstva koji je nadležan na osnovu privremenog ili stalnog boravka lica u vreme kada je naredba kojom je izrečena mera postala pravosnažna, ako konstatuje da nije više potrebno da izvršilac krivičnog dela bude tretiran ili zadržan u toj instituciji, sud koji je izrekao meru u prvostepenom postupku je ukida. Kad se mera ukine, sud može da naloži meru obaveznog tretmana na slobodi, ako postoje razlozi za izricanje takve mere.</p>
--	---	--

<p>5. Vendimi sipas paragrafit 4. të këtij neni merret pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe kryerësit të veprës penale nëse gjendja e tij këtë e lejon edhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit.</p> <p>6. Kur gjykata pushon masën, e informon institucionin e kujdesit shëndetësor, e liron personin ndaj të cilit është caktuar masa menjëherë pas marrjes së vendimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 172 Dhënja e ndihmës pas liritimit nga përkujdesja shëndetësore</p> <p>1. Pasi që personi të lirohet nga institucioni shëndetësor, organi kompetent i kujdestarisë është përgjegjës për personin ndaj të cilit është ekzekutuar masa në dhënien e ndihmës pas liritimit nga institucioni shëndetësor.</p> <p>2. Nëse kryerësi i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore lirohet nga institucioni shëndetësor, dhe nëse ai në institucionin shëndetësor ka kaluar kohë më të shkurtër sesa kohëzgjatja e burgimit të caktuar, gjykata e shqyrtton lirimin me kusht për atë person.</p>	<p>5. The decision according to paragraph 4 of this article is taken after hearing the state prosecutor, defense counsel and the perpetrator of the criminal offense if his condition allows this and after reviewing the opinion of the expert.</p> <p>6. When the court terminates the measure, it shall inform the health care institution, and shall release the person against whom the measure has been imposed immediately after the decision is made.</p> <p style="text-align: center;">Article 172 Providing assistance after release from health care</p> <p>1. After the person is released from the health institution, the competent custodial body is responsible for the person against whom the measure has been executed in providing assistance after release from the health institution.</p> <p>2. If the perpetrator who has committed a criminal offense in a state of reduced mental capacity is released from the health institution, and if he has spent less time in the health institution than the duration of the specified imprisonment, the court shall consider conditional release for that person.</p>	<p>5. Odluka iz stava 4 ovog člana donosi se odmah nakon saslušanja državnog tužioca, branioca i izvršioca krivičnog dela, ako njegovo stanje to dozvoljava i nakon razmatranja mišljenja eksperta.</p> <p>6. Kad sud ukida izrečenu meru, obavestiće zdravstvenu ustanovu da oslobodi lice prema kome je izrečena ova mera odmah nakon donošenja odluke.</p> <p style="text-align: center;">Član 172 Pružanje zdravstvene zaštite nakon otpusta</p> <p>1. Nakon što se lice pusti iz zdravstvene institucije, nadležni organ starateljstva je odgovoran za lice prema kome je izvršena mera za pružanje pomoći posle izlaska iz zdravstvene institucije.</p> <p>2. Ako je počinitelj izvršio krivično delo u stanju smanjene računljivosti, pušta se iz zdravstvene institucije i ako je u zdravstvenoj instituciji proveo kraće vreme od vremena trajanja izrečene zatvorske kazne, sud će da razmotri uslovno puštanje na slobodu tog lica.</p>
--	---	--

<p>3. Me rastin e vendosjes për lirim me kusht, gjykata veçanërisht merr parasysh suksesin e trajtimit të personit të dënuar, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucionin shëndetësor dhe kohën e mbetur të dënimit.</p> <p>4. Nëse gjykata vendosë për lirim me kusht, mundet gjithashtu ta caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, nëse ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë.</p> <p>5. Nëse gjykata vendosë që personi i dënuar të mbajë pjesën e mbetur të dënimit me burgim, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës e përcjellë atë në institucionin korrektues të dënimit.</p>	<p>3. When deciding on conditional release, the court shall particularly take into account the success of the treatment of the convicted person, his health condition, the time spent in the health institution and the remaining time of the sentence.</p> <p>4. If the court decides on conditional release, it may also impose a measure of compulsory psychiatric treatment at liberty, if there are grounds for imposing such a measure.</p> <p>5. If the court decides that the convicted person will serve the remainder of the prison sentence, the Kosovo Correctional Service staff shall refer him or her to the correctional facility.</p>	<p>3. U slučaju uslovnog puštanja na slobodu, sud posebno uzima u obzir uspeh tretmana osuđenog lica, njegovo zdravstveno stanje, vreme provedeno u zdravstvenoj instituciji kao i preostali deo za izdržavanje zatvorske kazne.</p> <p>4. Ako se sud odluči na uslovno oslobađanje, može da izrekne meru obaveznog psihijatrijskog tretmana na slobodi, ako postoje razlozi za izricanje takve mere.</p> <p>5. Ako sud odluči da osuđeno lice izdrži preostali deo kazne zatvora, osoblje Kazneno popravne službe Kosova dopratiće ga do kazneno popravne institucije na izdržavanje kazne.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 173 Ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri</p> <p>1. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri ekzekutohet në institucionin shëndetësor të caktuar nga gjykata që ka caktuar masën në shkallë të parë.</p> <p>2. Gjukata e informon institucionin shëndetësor për datën kur personi ndaj të cilit është caktuar masa duhet të paraqitet për trajtim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 173 Execution of the measure of compulsory psychiatric treatment at liberty</p> <p>1. The measure of compulsory psychiatric treatment at liberty is executed in the health institution designated by the court that imposed the measure in the first instance.</p> <p>2. The court shall inform the health institution about the date when the person against whom the measure has been imposed must appear for treatment.</p>	<p style="text-align: center;">Član 173 Izvršenje mere obaveznog psihijatrijskog lečenja na slobodi</p> <p>1. Mera obaveznog psihijatrijskog lečenja na slobodi se izvršava u zdravstvenoj instituciji koju odredi sud koji je izrekao meru prvostepenom presudom.</p> <p>2. Sud obaveštava zdravstvenu instituciju o datumu kad lice prema kome je izrečena mera mora da se prijavi na lečenje.</p>

<p>3. Personi ndaj të cilit është caktuar masa detyrohet të paraqitet në institucionin shëndetësor për trajtim brenda kohës së caktuar nga gjykata.</p> <p style="text-align: center;">Neni 174 Raportimi i institucionit të kujdesit shëndetësor</p> <p>1. Institucioni shëndetësor i dërgon gjykatës që ka caktuar masën në shkallë të parë raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit është ekzekutuar masa, së paku një (1) herë në gjashtë (6) muaj, dhe më shpesh me kërkesë të gjykatës.</p> <p>2. Kur institucioni shëndetësor çmon se më nuk është e nevojshme ta trajtojë personin ndaj të cilit është shqiptuar masa, menjëherë e informon gjykatën e cila ka caktuar masën në shkallë të parë.</p> <p>3. Gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë, sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e të pandehurit, mbrojtësit, institucionit shëndetësor, ose organit kompetent të kujdestarisë, e pushon masën nëse konstaton se më nuk është e nevojshme ta trajtojë personin ndaj të cilit është shqiptuar masa.</p>	<p>3. The person against whom the measure has been imposed is obliged to appear at the health institution for treatment within the time set by the court.</p> <p style="text-align: center;">Article 174 Reporting to the health care institution</p> <p>1. The health institution shall send to the court that has imposed the measure in the first instance a report on the health condition and success of the treatment of the person against whom the measure was executed, at least one (1) time in six (6) months, and more often at the request of court.</p> <p>2. When the health institution deems that it is no longer necessary to treat the person against whom the measure has been imposed, it shall immediately inform the court which has imposed the measure in the first instance.</p> <p>3. The court which has imposed the measure in the first instance, ex officio, or upon the proposal of the defendant, the defense counsel, the health institution, or the competent custodial body, shall terminate the measure if it finds that it is no longer necessary to treat the person against whom such measure was imposed.</p>	<p>3. Lice kome je izrečena ta mera je obavezno da se javi zdravstvenoj instituciji na lečenje na vreme koje sud odredi.</p> <p style="text-align: center;">Član 174 Izveštaj institucije za zdravstvenu zaštitu</p> <p>1. Zdravstvena institucija dostavlja izveštaj o zdravstvenom stanju i uspehu tretmana lica prema kome se izvršava ta mera, sudu koji je izrekao meru u prvom stepenu najmanje jedan (1) put u šest (6) meseci, ali i češće na zahtev suda.</p> <p>2. Kada zdravstvena institucija oceni da više nije potreban tretman za izvršioca krivičnog dela, odmah o tome obaveštava sud koji je izrekao tu meru u prvom stepenu.</p> <p>3. Sud koji je izrekao tu meru u prvom stepenu, po službenoj dužnosti ili na predlog optuženog, branioca, zdravstvene institucije ili nadležnog organa starateljstva, ukida meru ako zaključi da nije više potrebna za tretman izvršioca krivičnog dela.</p>
--	--	---

<p>4. Vendimi për pushimin e masës merret pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe personit ndaj të cilit është shqiptuar masa, nëse këtë e lejon gjendja e tij dhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 175 Masa e trajtimit</p> <p>1. Institucioni shëndetësor menjëherë e njofton gjykatën që e ka caktuar masën në shkallë të parë, kur personit ndaj të cilit është shqiptuar masa nuk i është nënshtruar trajtimit në liri nëse ai arbitrarisht e ka ndërprerë trajtimin, ose nëse mendon se trajtimi ka qenë i pasuksesshëm.</p> <p>2. Gjykata sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e institucionit shëndetësor, në të cilin personi trajtohet, ose duhet të trajtohet, mund të caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim nëse:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. kryerësi i veprës penale nuk i është nënshtruar trajtimit në liri, ka ndërprerë trajtimin arbitrarisht, ose kur trajtimi është konsideruar i pasuksesshëm nga institucioni i kujdesit shëndetësor;</p>	<p>4. The decision to terminate the measure is taken after hearing the state prosecutor, defense counsel and the person against whom the measure has been imposed, if his condition allows and after reviewing the opinion of the expert.</p> <p style="text-align: center;">Article 175 Measure of treatment</p> <p>1. The health institution shall immediately notify the court that imposed the measure in the first instance, when the person against whom the measure was imposed has not been subjected to treatment at liberty, if he has arbitrarily terminated the treatment, or if it considers that the treatment has been unsuccessful.</p> <p>2. Ex officio, or on the proposal of the health institution in which the person is treated, or should be treated, the court may prescribe compulsory psychiatric treatment with custody if:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. the perpetrator has not been subjected to treatment at liberty, has terminated treatment arbitrarily, or when the treatment has been deemed unsuccessful by the health care institution;</p>	<p>4. Odluka o ukidanju mere se donosi nakon saslušanja javnog tužioca, branioca i izvršioca krivičnog dela, ako to dozvoljava njegovo stanje i nakon razmatranja mišljenja eksperta.</p> <p style="text-align: center;">Član 175 Mera lečenja</p> <p>1. Zdravstvena institucija odmah obaveštava sud koji je izrekao tu meru u prvom stepenu, kad izvršilac nije podvrgnut tretmanu na slobodi, ako je isti samovoljno prekinuo tretman ili ako je mišljenja da je tretman bio neuspešan.</p> <p>2. Sud po službenoj dužnosti ili na predlog zdravstvene institucije u kojoj se to lice tretira ili je trebalo da se tretira, može da odredi meru obaveznog psihijatrijskog tretmana uz zadržavanje:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. ako izvršilac krivičnog dela nije podvrgnut tretmanu na slobodi, ako je samovoljno prekinuo tretman ili kada zdravstvena institucija oceni da se tretman smatra neuspešnim; i</p>
--	---	---

<p>2.2. ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë.</p> <p>3. Vendimi për caktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim merret pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe personit ndaj të cilit është shqiptuar masa, nëse këtë e lejon gjendja e tij dhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit të pavarur, i cili nuk është i punësuar në institucionin e kujdesit shëndetësor ku ekzekutohet masa.</p> <p>4. Pasi personi nuk ka më nevojë për trajtim në institucionin shëndetësor, organi kompetent i kujdestarisë është përgjegjës për personin ndaj të cilit është ekzekutuar masa në dhënien e ndihmës pas pushimit të trajtimit të detyrueshëm në liri.</p> <p>KAPITULLI VIII - EKZEKUTIMI I MASAVE TE PARABURGIMIT</p> <p>Neni 176 Mënyra e ekzekutimit të masës së paraburgimit</p> <p>1. Masa e paraburgimit sipas aktvendimeve të gjykatave kompetente ekzekutohet në institucionet përkatëse korrektuese.</p>	<p>2.2. there are reasons for imposing such a measure.</p> <p>3. The decision to impose the measure of compulsory psychiatric treatment with custody is taken after hearing the state prosecutor, defense counsel and the person against whom the measure has been imposed, if his condition allows and after reviewing the opinion of the independent expert, who is not employed in the health care institution where the measure is executed.</p> <p>4. After the person no longer needs treatment in the health institution, the competent custodial body is responsible for providing help to the person against whom the measure was executed after the termination of compulsory treatment at liberty.</p> <p>CHAPTER VIII - EXECUTION OF DETENTION MEASURES</p> <p>Article 176 Manner of execution of the detention measure</p> <p>1. The detention measure according to the rulings of the competent courts is executed in the relevant correctional institutions.</p>	<p>2.2. ako postoje razlozi za određivanje takve mere.</p> <p>3. Odluka o određivanju mere obaveznog psihijatrijskog tretmana sa zadržavanjem se donosi nakon saslušanja javnog tužioca, branioca i izvršioca krivičnog dela, ako to dozvoljava njegovo stanje i nakon razmatranja mišljenja nezavisnog eksperta koji nije zaposlen u zdravstvenoj instituciji u kojoj se izvršava ta mera.</p> <p>4. Kada lice više nema potrebe za tretman u zdravstvenoj instituciji, nadležni organ starateljstva je odgovoran za lice prema kome je izvršena ta mera za pružanje pomoći nakon prestanka obaveznog tretmana na slobodi.</p> <p>POGLAVLJE VIII - IZVRŠENJE MERE PRITVORA</p> <p>Član 176 Način izvršenja mera pritvora</p> <p>1. Mera pritvora na osnovu rešenja nadležnog suda izvršava se u nadležnoj kazneno popravnoj ustanovi.</p>
--	--	---

<p>2. Në veprimin me personat në paraburgim aplikohen dispozitat përkatëse të Kodit për procedurën penale dhe dispozitat e këtij ligji.</p> <p>3. Me kërkesën e prokurorit dhe nëse ajo është në interesin e drejtësisë, gjykata mund të urdhërojë që të kufizohen të drejtat e caktuar të personit në paraburgim</p> <p style="text-align: center;">Neni 177 Vendosja e personit të paraburgosur</p> <p>1. Në institucionin përkatës korrektues mund të vendoset personi për të cilin gjykata kompetente ka nxjerr aktvendim për caktimin e paraburgimit. Bashkë me aktvendimin për caktimin e paraburgimit, institucionit korrektues përkatës i dërgohet edhe urdhëri me shkrim për pranimit të personit të paraburgosur.</p> <p>2. Institucioni korrektues përkatës lëshon vërtetim me shkrim për pranimitin e të paraburgosurit, në të cilin përveç tjerash shënohet, dita dhe ora e pranimit, emri dhe mbiemri i personit i cili e ka sjellë të paraburgosurin.</p>	<p>2. In dealing with persons in detention on remand, the relevant provisions of the Code of Criminal Procedure and the provisions of this law shall apply.</p> <p>3. At the request of the prosecutor and if it is in the interest of justice, the court may order that certain rights of the person in detention be restricted.</p> <p style="text-align: center;">Article 177 Detention of a detainee</p> <p>1. The person for whom the competent court has issued a decision on detention on remand may be placed in the relevant correctional facility. Along with the ruling on detention on remand, a written order for the admission of the detainee is sent to the relevant correctional facility.</p> <p>2. The relevant correctional facility shall issue a written certificate of admission of the detainee, stating, inter alia, the day and hour of admission, the name and surname of the person who brought the detainee.</p>	<p>2. U radu sa pritvorenim licima shodno se primenjuju odredbe Zakonika o krivičnom postupku i odredbe ovog Zakona.</p> <p>3. Na zahtev tužioca i ako je to u interesu pravde, sud može da naloži ograničenje prava pritvorenim licima.</p> <p style="text-align: center;">Član 177 Smeštaj pritvorenog lica</p> <p>1. U nadležnoj kazнено popravnoj ustanovi mogu da se smeste lica kojima je nadležni sud rešenjem odredio pritvor. Uz rešenje o određivanju pritvora nadležnoj kazнено popravnoj ustanovi dostavlja se i pisani nalog za prijem lica kojem je određen pritvor.</p> <p>2. Nadležna kazнено popravna ustanova izdaje pisanu potvrdu da je primila lice kojem je određen pritvor u kojem je između ostalog naveden datum i sat prijema i ime i prezime lica koje se smešta u pritvor.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 178 Kontrollimi mjekësor dhe njoftimi me të drejtat e tij</p> <p>1. Menjëherë pas pranimit në institucioni korrektues përkatës, kryhet kontrolli mjekësor i të paraburgosurit, ndërsa konstatimi dhe mendimi i mjekut shënohet në kartonin shëndetësor të paraburgosurit.</p> <p>2. Pas pranimit në institucion korrektues përkatës, i paraburgosuri njoftohet me aktin nënligjor për rendin e brendshëm shtëpiak, për ekzekutimin e masës së paraburgut, të drejtat dhe detyrimet e tjera gjatë kohës së zbatimit të masës së paraburgut.</p> <p>3. Të paraburgosuri të cilët së bashku kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale sistemohen në lokale të veçanta.</p>	<p style="text-align: center;">Article 178 Medical examination and notification of his rights</p> <p>1. Immediately after admission to the relevant correctional facility, the detainee undergoes a medical examination, while the doctor's statement and opinion are recorded on the detainee's health record.</p> <p>2. Upon admission to the relevant correctional facility, the detainee shall be notified of the by-law on internal house rules, the execution of the detention measure, other rights and obligations during the application of the detention measure.</p> <p>3. Detainees who together participated in the commission of a criminal offense are placed in separate premises.</p>	<p style="text-align: center;">Član 178 Lekarski pregled i obaveštavanje o njegovim pravima</p> <p>1. Odmah po prijemu u nadležnu kazneno popravnu ustanovu obavlja se lekarski pregled pritvorenog lica a nalaz i mišljenje lekara se upisuju u zdravstveni karton pritvorenika.</p> <p>2. Po prijemu u nadležnu kazneno popravnu ustanovu pritvorenik se upoznaje sa podzakonskim aktom o internom kućnom redu za izvršenje mere pritvora i drugim pravima i obavezama koje ima u toku trajanja mere pritvora.</p> <p>3. Pritvorenici koji su zajednički učestvovali u obavljanju krivičnog dela smeštaju se u izdvojene prostorije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 179 Kushtet për personat në paraburgim</p> <p>1. Të paraburgosurit në institucionin korrektues përkatës qëndrojnë nën kushtet e njëjta sikurse edhe personat e dënuar lidhur me vendosjen, ushqimit, mbrojtjes shëndetësore, përdorimit të masave të dhunës, të masave të veçanta për mbajtjen e rendit dhe sigurisë, dhe kompensimit për</p>	<p style="text-align: center;">Article 179 Conditions for persons in detention on remand</p> <p>1. Detainees in the relevant correctional facility are held under the same conditions as convicted persons in connection with accommodation, food, health care, use of coercive measures, special measures to maintain order and security, and compensation for damage caused during the</p>	<p style="text-align: center;">Član 179 Uslovi za lica u pritvoru</p> <p>1. Pritvorenici u nadležnoj kazneno popravnoj ustanovi borave pod istim uslovima kao i osuđena lica u pogledu smeštaja, ishrane, zdravstvene zaštite, primene prinudnih mera, posebnih mera za održanje reda i sigurnosti i naknade za štetu nastalu u toku primene mere pritvora.</p>

<p>dëmin e shkaktuar gjatë kohës së zbatimit të masës së paraburgut.</p> <p>2. Në rast nevojë të ruajtjes të paraburgosurit gjatë kohës së qëndrimit jashta institucionit korrektues sipas cilësdo bazë, sigurinë e kryen SHKK, në raste të veçanta në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 180 E drejta për punë e personit në paraburgim</p> <p>1. I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.</p> <p>2. I paraburgosuri i cili punon, ka të drejtë në kompensim dhe të drejta tjera në bazë të punës në pajtim me këtë Ligj që u takojnë personave të dënuar.</p>	<p>time of the application of the detention measure.</p> <p>2. In the event of the need to secure the detainee while outside the correctional facility on any grounds, the security is performed by KCS, in special cases in cooperation with the Kosovo Police.</p> <p style="text-align: center;">Article 180 The right of detainee to work</p> <p>1. The detainee may be engaged in workshops, workshops of economic units which are located in the surroundings of the respective correctional institution, after obtaining the consent of the competent court.</p> <p>2. A detainee who works has the right to compensation and other work-based rights that convicted persons are entitled to in accordance with this Law.</p>	<p>2. U slučaju potrebe da se pritvorenik u toku boravka čuva van nadležne kazneno popravne ustanove po bilo kojem osnovu, bezbednost pruža KPU, u posebnim slučajevima u saradnji sa kosovskom policijom.</p> <p style="text-align: center;">Član 180 Pravo pritvorenika na rad</p> <p>1. Pritvorenik može da se angažuje na radu u radionici, radionici u ekonomskim jedinicama koje se nalaze unutar nadležne kazneno popravne ustanove, posle dobijanja saglasnosti od nadležnog suda.</p> <p>2. Pritvorenik koji radi ima pravo na naknadu i druga prava po osnovu rada koja se odnose na osuđena lica u skladu sa ovim Zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 181 Shkeljet disiplinore gjatë paraburgimit</p> <p>1. Nëse gjatë kohës së ekzekutimit të masës, i paraburgosuri kryen shkelje disiplinore, apo cilën do kundërvajtje, drejtori i</p>	<p style="text-align: center;">Article 181 Disciplinary violations during detention</p> <p>1. If during the execution of the measure, the detainee commits a disciplinary violation, or any minor offense, the director of the</p>	<p style="text-align: center;">Član 181 Disciplinski prekršaji tokom pritvora</p> <p>1. Ako u toku izvršenja mere pritvora pritvorenik izvrši disciplinsku povredu ili neki prekršaj, direktor popravne ustanove</p>

